



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:031820

Datë: 18.06.2021

Numri i dokumentit: 01901859

P. nr.102/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit D. M. nga Prizreni ,për shkak të veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë, PP/II.nr. 265/20 të dt.26.02.2020 në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë **17.06.2021**, në prani të Prokurorit të shtetit Enis Gashi dhe të akuzuarit , të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **D. M.** nga Prizreni , Rr”. . . ,data e lindjes . . . në fsh. Denjë K Rahovec ,i biri i L. dhe i nënës B. e gjinisë B., ka të kryer shkollën e mesme , vozitës , i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar ,shtetas R. Kosovës, i pa martuar, me ID . . . ,nr.tel . . .

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse :

-me datë **13.02.2020**, rreth orës **10:30 min.** ,në Rr. “. . .”,në Gjakovë , i pandehuri D. M. me dashje ja dëmton pasurinë të dëmtuarës L. M. ,në atë mënyrë që ditën kritike derisa i njëjti i merr dokumentet e veturës “. . .”,pronë e babait të tij të ndjerë ,kinse për rregullimin e dokumentacionit për trashëgimi , i njëjti kthehet pas një ore dhe ia kërkon të dëmtuarës çelësat e veturës , pasi që e dëmtuara refuzon t’ia jap , i pandehuri kishte marr një guri në oborr (kubëz) dhe kishte goditur disa herë veturën “. . .”, me tar. regj , . . . , ngjyre e zezë ,duke ia thyer xhamin e derës së pasme nga ana e djathë si dhe dëmtuar derën e parë nga ana e pasagjerit .

-me çka ka kryer veprën penale, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69, 70, si dhe nenit 321par.1 të KPRK dhe nenit 365 të KPPK-së, -së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Dënim gjobë në shumë prej **200(dyqind) euro** ,të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarrimit me hunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 43 par.3 të KPRK-së ,atëherë i njëjti i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)**.

E dëmtuara L. M. nga Gjakova, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30,00 €**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej **20,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr. 265/20 të datës 26.02.2020 ka akuzuar të akuzuarin D. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-ës .

Me dt. 10.11.2020 , Gjykata ka lëshuar urdhër arrest P.nr. 102/20, me që i njëjti nuk ka marr pjesë në seancat e caktuara për të cilin është lëshuar urdhëresë për shoqërim me detyrim për të njëjtin e po ashtu është kërkuar edhe nga av. Esat Gutaj adresa e të akuzuarit i cili ka dhënë këtë adresë. “. . . , i njëjti është ftuar edhe në këtë adresë por në flet kthesë konstatohet adresa e panjohur , kështu që kjo gjykatë ka marr Aktvendimin P.nr.102/20 të dt. 10.11.2020, me të cilin pezullohet mbajtja e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale ndaj të akuzuarit D. M. , dhe ndaj të njëjtit gjykata ka lëshuar urdhër arrest P.nr. 102/20 , për të siguruar prezencën e tij në shqyrtimin gjyqësor.

Me dt. 17.06.2021 nga st. Policor ne Prizren duke vepruar sipas urdhër arrestit i njëjti është shoqëruar në lokalet e gjykatës në Gjakovë, ku i njëjti është proceduar dhe gjykata ka tërheq urdhër arrestin.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 17.06.2021, Prokurorja shtetit Enis Gashi lexon aktakuzën PP.nr. 265/20 të datës 26.02.2020, me ç rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari D. M. , në shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë, thekson se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohem sipas aktakuzës dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimin të fajësisë . shtojë se me pranimin e fajësi në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer në afekt ,me qenë se automjetin në fjalë ka qene pronë e babait tim , premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem me i kujdesshëm duke i kërkuar falje nga e dëmtuara për veprimet e mijja edhe pse tani këto çështje lidhur me trashëgimin i kemi zgjidhur deri diku ,andaj bazuar në të gjitha këto i propozoi gjykatës që te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë , pendimin e shprehur ne gjykate dhe premtimin se një veprim i tillë nuk do te përsëritet ,te me shqiptojë një dënim me te butë me qe është hera e parë qe kam ra ndesh me ligjin.

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë prokurori i shtetit Enis Gashi ,,thekson se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari D. M. pasi qe të njëjtin pranimin e fajësisë e ka bere në mënyrë vullnetare dhe pa presion duke i kuptuar pasojat dhe favorret e pranimin të fajësisë te sqaruara nga ana gjykatës ,e duke marr parasysh se aktakuza ka mbështetje ne provat personale dhe material ne bazë te cilave është paraqitur gjendja faktike ne dispozitiv ku edhe përmbushen te gjitha elementet e veprës penale me te cilat ngarkohet i akuzuari .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari D. M. : **-me datë 13.02.2020, rreth orës 10:30 min. ,në Rr. “. . .”,në Gjakovë** , i pandehuri D. M. me dashje ja dëmton pasurinë të dëmtuarës L. M. ,në atë mënyrë që ditën kritike derisa i njëjti i merr dokumentet e veturës “. . .”,pronë e babait të tij të ndjerë ,kinse për rregullimin e dokumentacionit për trashëgimi , i njëjti kthehet pas një ore dhe ia kërkon të dëmtuarës çelësat e veturës , pasi që e dëmtuara refuzon t'ia jap , i pandehuri kishte marr një guri në oborr (kubëz)

dhe kishte goditur disa herë veturën “. . .”, me tar. Regj , . . . , ngjyre e zezë ,duke ia thyer xhamin e derës së pasme nga ana e djathtë si dhe dëmtuar derën e parë nga ana e pasagjerit .

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari ,i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë ,pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit ,më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethanë rënduese gjykata konsideron faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi , ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës , sjelljen korrekte në gjykim, kërkim falja nga e dëmtuara për dëmin e shkaktuar ,premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, gjendjen e dobët ekonomike, si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka ra ndesh me ligjin . Kështu që gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me gjobë ne shumë prej 200.00(dyqind) euro ,me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se ky sanksion do të ndikoj tek të akuzuarit që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit si dhe forcimi e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në shumë prej 20.00€ në emër të paushallit gjyqësor është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € është marr konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimin.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,

P. nr.102/20 më datë 17.06.2021

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 , ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.